

URDHËR
Nr. 598, datë 17.10.2023

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 370, DATË 29.7.2014, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES, ‘MBI PRODUKTET MJEKËSORE VETERINARE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 85, pika 1, nenit 88, nenit 92, nenit 94, nenit 102 dhe nenit 104, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit,

URDHËROJ:

Ndryshimin e urdhrit nr. 370, datë 29.7.2014, si vijon:

1. Në rregullore, pas nenit 10, shtohet neni 10/1, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, që bëhet pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

Antimikrobikët ose grupet e antimikrobikëve të mëposhtëm, të përcaktuar si të rezervuar për trajtimin e infeksioneve të caktuara te njerëzit, nuk do të përdoren në produkte mjekësore veterinarë ose në ushqimin e medikuar për kafshë:

1. Antibiotikët
a) Carboxypenicillins
b) Ureidopenicillins
c) Ceftobiprole
ç) Ceftaroline
d) Kombinimet e cefalosporinave me frenuesit beta-laktamazë
dh) Siderophore cephalosporins
e) Carbapenems
ë) Penems
f) Monobactams
g) Phosphonic acid derivatives
gj) Glycopeptides
h) Lipopeptides
i) Oxazolidinones
j) Fidaxomicin
k) Plazomicin
l) Glycylcyclines
ll) Eravacycline
m) Omadacycline
2. Antiviralë
a) Amantadine
b) Baloxavir marboxil
c) Celgosivir
ç) Favipiravir
d) Galidesivir
dh) Lactimidomycin
e) Laninamivir
ë) Methisazone/metisazone
f) Molnupiravir
g) Nitazoxanide
gj) Oseltamivir

h) Peramivir
i) Ribavirin
j) Rimantadine
k) Tizoxanide
l) Triazavirin
ll) Umifenovir
m) Zanamivir
3. Antiprotozoarë
a) Nitazoxanide

Ndalohet përdorimi në kafshë i produkteve mjekësore për përdorim njerëzor që përmbajnë ndonjë nga antimikrobikët ose grupet e antimikrobikëve të listuar më sipër.